



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0540

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) GEOCAD Group SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KUVENDI KOMUNAL - RAHOVEC në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1, me 17/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar ankesa e OE GEOCAD Group SH.P.K. me nr. 2023/0540, e datës 03/08/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË lidhur me aktivitetin e prokurimit “DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik GEOCAD Group SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.05.2023, KUVENDI KOMUNAL - RAHOVEC në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1. Ndërsa me datën 20.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 124,000.00€.

Me 25.07.2023, OE GEOCAD Group SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 25.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE GEOCAD Group SH.P.K. me nr. 540/23 lidhur me aktivitetin “DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “GEOCAD Group” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankuesi pretendonse “Me datë 21.07.2023, ne kemi pranuar dokumentacionin e kompanive tjera (ne USB). Pas kontrollit të dokumentacionit, kemi vërejtur se grupit të OE fitues i mungonin Vërtetimi i ATK-s për kompaninë GJEODETI dhe certifikatat e Gjykatës për të dy kompanitë në konsorcium. Ne me datë 21.07.2023 kemi kërkuar përmes emailit që të na ofroni të skanuara dokumentet të cilat mungonin në USB. Me datë 24.07.2023, ju si AK na jeni përgjigjur përmes emailit, ku dhe keni bashkangjitur dokumentet. Në bazë të fotografisë së paraqitur më

lartë, ju keni dërguar: 1_një dokument të Gjykatës për dënime penale për Blerim Halilaj (si person fizik) që përmban datën 24.07.2023 (njoftimi mbi vendim është me datë 20.07.2023!!!), 2_Vertetimi i ATK-s për kompaninë GJEODETI me datë 24.07.2023 (njoftimi mbi vendim është me datë 20.07.2023!!!), 3_Vertetimi i ATK-s për kompaninë GLOBI CONSULTING me datë 24.07.2023 (njoftimi mbi vendim është me datë 20.07.2023!!!), 4_Qertifikata e Gjykatës për kompaninë GLOBI CONSULTING me datë 21.07.2023 (njoftimi mbi vendim është me datë 20.07.2023!!!). Kompania GJEODETI nuk ka prezantuar fare certifikatën e Gjykatës sipas Nenit 65 të LPP-s dhe Pikës “i” paragrafi “b” i Udhëzuesit Nr.001/2023! Të nderuar, në kllapa kemi vendosur datën e vendimit tuaj për shpallje të fituesit, e cila datë nëse bazohemi në Ligjin e Prokurimit, duhet të jetë në të njëjtën ditë ose pas datës që janë prezantuar vërtetimet e ATK-s (për dy kompanitë) dhe certifikatat e Gjykatës! Bazuar në këtë që cekëm më lartë, ju keni bërë shkelje të ligjit të prokurimit, Nenit 65 të tij, konkretisht Pikës “i” i Udhëzuesit Nr.001/2023 ku thuhet qartë: “Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.” Me shpalljen fitues të GOE, ju keni bërë shkelje të dispozitave të cekura më lartë dhe me këtë rast, ju duhet që të bëni Rivlerësimin e vendimit tuaj, Grupin e OE që keni shpallur fitues t’a eliminoni!”

Pretendimi i dytë (II) ankuesi pretendon se “Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ju në arsyetimin e parë keni cekur se OE duhet të ketë në listë një Bachelor të diplomuar në Gjeografi me 3 vite përvojë pune pas diplomimit (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në fushën e hartave GIS). Në përbërjen e stafit tonë, ne kemi paraqitur 3 bachelor të gjeografisë në total. Pikën 1.2 sipas kërkesave në FDT e plotëson saktë bachelor-i i gjeografisë, konkretisht eksperti dhe trajnuesi i GIS-it, Z.Mesud Kuka. Z.Kuka ka mbaruar bachelorin në gjeografi me 6 korrik 2007 në bazë të diplomës nr.1097. Nga kjo rezulton se Z. Kuka ka përvojën më se të mjaftueshme pas diplomimit në fushën e kërkuar si në pikën 1.2 të FDT-s. Njëherit konfirmojmë se i njëjti ka përvojë të madhe në GIS, konkretisht në hartografi të cilën e paraqet edhe përmes CV-s së tij (bashkangjitur në dosje). Gjatë vendosjes së stafit në listë, administratorit që bënë plotësimin e dosjeve të tenderëve në kompaninë tonë i ka rrjedhur një gabim teknik, kur është bërë renditja e stafit sipas kërkesave, dhe me këtë rast, gabimisht është vendosur Z. Jetmir Bytyçi në pozitën e ekspertit të GIS-it, e që në këtë pozitë duhet të jetë Z. Mesud Kuka, pra ne si OE ofertuese e kemi përcaktuar Z. Kuka për ekspert të GIS-it! Pra, bazuar në këtë, ne deklarojmë se Z. Mesud Kuka është në pozitën e ekspertit të GIS-it, ndërsa Z. Jetmir Bytyqi është në pozitën e hulumtuesit të terrenit. Ne e kemi pasur parasysh se Z. Bytyçi nuk plotëson kërkesën 1.2, për këtë arsye ai është vetëm hulumtues terreni. Për të konfirmuar se Z. Kuka plotëson kërkesën 1.2, ju lutem referojuni dokumentacionit në dosje. Me qenë se ne jemi OE me çmimin më të lirë, bazuar në Nenin 59

paragrafi 2 dhe nenin 72 të LPP-s, ju keni pasur mundësi që gjatë procedurës së vlerësimit të kërkonit informacione shtesë, e jo të na eliminoni direkt! Bashkangjitur kësaj kërkesë për rishqyrtim, do ju dërgojmë edhe listën e përmirësuar (përmirësimin e gabimit teknik)."

Pretendimi i tretë (III) ankuesi pretendon se “ Në letrën standarde të pjesa e arsytimit të dytë, ju keni paraqitur një arsyetim shumë të çuditshëm dhe njëherit bazuar në llojin e procedurës që ju keni vendosur të përfillni (kontratë kornizë), mendojmë se ky arsyetim që ju keni paraqitur bije ndesh me Ligjin! Me qenë se ju si AK, për të na eliminuar neve, keni paraqitur arsyetimin se Komunes së Rahovecit në bazë të llogaritjeve tuaja, oferta jonë do i kushtoj 315,815.00 Euro, atëherë pse ju si AK në bazë të Ligjit të LPP-së, konkretisht nenit 38 paragrafit 2 të këtij ligji dhe Nenit 17.12 dhe 17.17 të RRUOPP-s, e në theks të veçantë nenit 17.34 të RRUOPP-s ku thuhet qartë se: 17.34 Në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasitë mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikimi i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Sasitë duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit, nuk e keni paraqitur vlerën indikative të afërsishme!? Në bazë të nenit 17.34 të RRUOPP-s ju si AK bazuar në arsyetimin e dytë për eliminim tonë , paskeni pasur informacione indikative të afërsishme për pikën e parë dhe të dytë nga paramasa, dhe me këtë rast, nuk e keni paraqitur fare në dosje, të cilën keni pasur 7/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK mundësi që ta shënoni edhe si vërejtje, e jo ta përdorni pastaj për të eliminuar kompani të caktuara! Nëse shikojmë me kujdes paramanën që ju keni paraqitur, vërehet qartë se vetëm për pikat 1 dhe 2 të paramasës ju keni vendosur njësit “Kilometër” dhe “metër”, për pozicionin 3, kur dihet se ka për tu krijuar vetëm një platformë ËEB (bazuar në specifikacion teknik) keni paraqitur “copë”, që në këtë rast dihet se është vetëm një copë, një aplikacion, për pikat 4 dhe 5 ku kërkohet trajnimi i stafit, në specifikacion keni paraqitur 3 ditë dhe 50 orë trajnim, pra i keni precizuar. Për pikat tjera nga 6 deri në 18, ku në të vërtetë e keni pasur të pamundur llogaritjen e numrit të njësisve keni vendosur njësinë “kompet”. Bazuar në këtë që cekëm më lartë, nëse keni pasur informacione për sasitë si në pikën 1 dhe 2, keni mundur që ti paraqitni në specifikacion teknik, siç keni bërë me pikat 3 deri 5. Me qenë se nuk i keni paraqitur sasitë indikative të afërsishme, në këtë rast, Ju si AK nuk mund të përdorni llogaritje si në arsyetim për të na eliminuar neve si OE me çmimin më të ulët! Ky është veprim diskriminues bazuar në dispozitat kryesore të Ligjit të Prokurimit publik, konkretisht nenet 1, 2.1, 6, 7.1, 7.2 dhe 7.4 të LPP-së.” Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 9- Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, thuhet se: “ . Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara 20 funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë;”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “GEOCAD Group” SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2.1, 6, 7.1, 7.2, 7.4, 38.2, 59.2, 65, 72 të LPP dhe shkeljet e dispozitave të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 540/23, ndërsa me datë 21/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0540 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “GEOCAD Group” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0540 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar pasi që *“Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues vërtetimet të cilat janë cekur edhe në Dosje të Tenderit se OE i rekomanduar duhet t’i dorëzoj pasi që të propozohet për shpërblim të kontratës, përkatësisht Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Vërtetimi nga Gjykata, janë dokumente të cilat dorëzohen nga OE i rekomanduar pasi që të merr njoftimin për shpërblim dhe pas kërkesës të bërë nga Autoriteti Kontraktues. Pra, nëse AK nuk e ka dërguar njoftimin me kohë dhe nuk ka kërkuar nga OE i rekomanduar që të dorëzoj edhe dokumentet përkatëse para datës së publikimit të njoftimit, nuk mund të merret si arsye për eliminim të OE. Pra OE i rekomanduar nuk mund të jetë përgjegjës kur vet AK nuk e ka bërë një kërkesë të tillë me kohë.”*

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar pasi qe “ AK në dosjen e tenderit tek fusha e kërkesave profesionale ka cekur që stafi i cili do të angazhohet varësisht prej pozitës duhet të ketë edhe kualifikimet dhe përvojën e kërkuar. OE ankues në listën e stafit të cilën e ka dorëzuar pretendon se ka lëshuar një gabim teknik ku në vend se të vendoste z. Mesud Kuka si ekspert dhe trajnues i GIS-it, ata kanë vendosur z. Jetmir Bytyçi. Duke u bazuar në nenin 59 të Ligjit të Prokurimit Publik, pika 4 thotë se: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Duke marr parasysh këto devijime të vogla të cilat janë bërë nga ana e OE ankues dhe të cilat lejohen edhe me LPP, AK është dashur që të kërkoj sqarime shtesë kur ka parë se OE nuk e ka dorëzuar listën si duhet për shkak të gabimit teknik në listën e stafit profesional dhe jo të përdor si arsyetim për eliminim të OE.

Pretendimi i tretë (III) ankimor është i bazuar pasi qe “Eksperti shqyrtues sqaron se në kërkesën për rishqyrtim AK ka pranuar se sa i përket pozicionit 1 dhe 2 në Listën e çmimeve e di saktë numrin e km/m’ të rrugëve dhe trotuareve të Komunës së Rahovecit të cilat kërkohet të digjitalizohen me këtë aktivitet prokurimi, por edhe pse AK e ka pasur këtë njohuri, të njëjtat nuk janë vendosur as në Dosje të Tenderit dhe as në Listën e çmimeve por në vend të saj është vendosur sasia 1. Sipas neni 9 të LPP-së e specifikon qartë se duhet të përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t’i plotësojë. Pra, në momentin kur AK ka njohuri të sakta për sasi të kërkuara, të njëjtat është dashur të vendosen edhe në DT edhe në Listën e çmimeve dhe jo të vendoset sasia 1, e cila vendoset në rastet kur Autoriteti Kontraktues nuk mund të planifikoj saktë sasi të shërbimeve të caktuara. Andaj konsiderojmë se në këtë rast AK- Komuna e Rahovecit ka bërë shkelje të nenit 8 dhe nenit 9 të LPP-së për planifikimin e prokurimit dhe përcaktimin e nevojave që duhet përmbushur dhe pretendimi i ngritur nga OE ankues është **i bazuar**.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ia fal besimin ekspertit shqyrtues dhe ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI KOMUNAL - RAHOVEC

datës 20.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “prokurimit DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin 1 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - GEOCAD Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: